



Deklaratë për shtyp – 363/05/2020

Plan për hapjen graduale të sektorit të kujdesit ditor për fëmijë në Nordrhein-Westfalen

Hapat për hapjen e mëtejshme do të zhvillohen më 14 dhe 28 Maj 2020/ Ministri Stamp: Të lejohet sa më shpejt dhe sa më përgjegjshmërisht të jetë e mundur veprimtaria e rregullt e kufizuar për të gjithë fëmijët

11.05.2020
Faqja 1 nga 3

Zyra për shtyp e
kancelarisë së shtetit
40213 Düsseldorf
Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405
ose 0211 837-1151

presse@stk.nrw.de

Ministria e Fëmijëve, Familjes, Refugjatëve dhe Shëndetësisë ju informon:

Nordrhein-Westfalen nis hapjen e mëtejshme të sektorit të kujdesit ditor për fëmijë dhe ka prezantuar një plan për këtë gjë, duke marrë në konsideratë shkallën aktuale të infeksionit. Si rrjedhim, nga 14 Maji 2020, më shumë fëmijë do të jenë në gjendje të ndjekin gradualisht kujdesin ditor. Ky plan është koordinuar ngushtë me komunat dhe institucionet sponsorizuese dhe është diskutuar me prindër, sindikata dhe përfaqësues të kujdesit për fëmijë. Ministri i Familjes Joachim Stamp i dërgon letra prindërve, institucioneve sponsorizuese, punonjësve, drejtuesëve të qendrave të kujdesit ditor për fëmijë dhe personave të cilët merren me kujdesin ditor për fëmijë duke i shpjeguar masat e ardhshme.

Ministri Stamp: „Pasojat e koronavirusit janë veçanërisht të mëdha për fëmijët dhe familjet. E kuptoj presionin e pamasë që qëndron veçanërisht mbi familjet me fëmijë të vegjël pas shumë javësh pa kujdesin ditor të rregullt për fëmijët. Shpesh, kujdesi për fëmijët dhe puna janë të përballueshme vetëm me mundimin më të madh. Si babai i dy fëmijëve jam i vetëdijshtëm që fëmijët kanë nevojë për kontakt social, hapësirë për të luajtur, lodruar dhe mësuar. Megjithëse do të dëshironim të hapnim kujdesin ditor për të gjithë fëmijët, duhet të veprojmë ngadalë dhe me përgjegjësi. Kjo ndodh sepse specialistët e qendrave të fëmijëve dhe të kujdesit ditor, të cilët i përkasin grupit në rrezik, nuk janë tani në gatishmëri. Kjo gjë e kufizon në mënyrë të konsiderueshme propozimin dhe mund të zgjerohet momentalisht vetëm me hapa të kujdesshëm .“

Gjithsesi, qëllimi është t'u jepet të gjithë fëmijëve mundësia e edukimit të hershëm të fëmijërisë sa më shpejt të jetë e mundur. Fillimisht kujdesi emergjent do të zgjerohet në dy hapa, më 14 dhe 28 Maj 2020. Në një hap tjetër në Qershor, të gjithë fëmijët e tjerë do të rilidhen me qendrat e kujdesit ditor për fëmijë. Forma dhe masa në të cilën mund të ndodhë kjo varet nëse zhvillimi përsëri lejon për grupe më të mëdha dhe sa

specialistë janë në gatishmëri. Ministri i familjes Stamp: „Është e qartë se ne duam të mundësojmë sa më shpejt dhe sa më përgjegjshëm të jetë e mundur të paktën një veprimtari të rregullt të kufizuar për të gjithë fëmijët.“

Plani për hapjen e sektorit të kujdesit ditor të fëmijëve:

Rregullorja e tanishme

- Kujdes emergjent i kufizuar: Është e ndaluar hyrja në qendrat dhe ambientet e kujdesit për fëmijë. Përrjashtim bëjnë fëmijët prindërit e të cilëve i përkasin grupeve të veçanta profesionale dhe sigurohet shëndeti i fëmijës në raste individuale.
- Kujdes emergjent i zgjeruar: Prindër beqarë të punësuar dhe prindër beqarë në provimet përfundimtare të arsimit shkollor ose universitar.

Duke filluar nga 14 Maj 2020:

- Kujdesi në qendrat e kujdesit ditor do të hapet për fëmijë parashkollorë për të cilët rezultojnë pranueshmëria sipas Paketës së Edukimit dhe Pjesëmarrjes (Bildungs- und Teilhabepaket).
- Për më tepër, fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve të rrezikuar nga paaftësi madhore, të cilëve kjo gjë u është përcaktuar nga një institucion i suportit të integrit, mund t'u ofrohet përsëri kujdes në ambiente ose qendra të kujdesit ditor. Një implementim përkatës për kujdesin e fëmijëve në grupet e arsimit kurativ duhet të zhvillohet brenda mundësive ekzistuese.
- Qendrat e kujdesit ditor me mjediset e tyre të menaxhueshme dhe të përshtatura për familje do t'u hapen fëmijëve të cilët kanë arritur moshën dy vjeç.
- Projektet e urave mund të hapen përsëri.
- Kujdesi privat për fëmijë i organizuar nga prindërit është i mundshëm në kushte të caktuara.

Duke filluar nga 28 Maji 2020:

- Do të pranohen të gjithë fëmijët e tjerë parashkollorë.

Hapa të tjerë në Qershor:

- Gjatë muajit qershor të gjithë fëmijët e tjerë do të mund të ndjekin qendrën ose ambientin e tyre të kujdesit ditor. Masa në të cilën ky propozim do të realizohet, do të rishikohet vazhdimisht dhe do të koordinohet me komunat dhe institucionet sponsorizuese dhe do të zhvillohet sipas këshillimit me prindërit dhe sindikatat, si dhe me shoqatat për kujdesin ditor të fëmijëve.

Na ndiqni në internet:

Twitter: [@chancennrw](#)

Facebook: [Chancen NRW](#)

Instagram: [chancennrw](#)

YouTube: [Chancen NRW](#)

Nëse keni pyetje të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni zyrën e shtypit të Ministrisë së Fëmijëve, Familjes, Refugjatëve dhe Integritetit, Tel. 0211 837-2417.

Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Republikës www.land.nrw

[Njoftim për mbrojtjen e të dhënave në lidhje me rrjetet sociale](#)